



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

Nr. 2281/1 Prot.

Tiranë, më 12.06.2026

VENDIM

Nr. 93 , datë 10.06.2026

**“PËR CAKTIMIN E PËRKOHSHËM NË POZICIONIN E DREJTUESIT TË
PROKURORISË PRANË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË TË JURIDIKSIONIT
TË PËRGJITHSHËM FIER”**

Këshilli i Lartë i Prokurorisë, i përbërë nga:

1. Mirela BOGDANI	Kryetar
2. Erind GERMENJI	Zv/kryetar
3. Sokol STOJANI	Anëtar
4. Zeqir HODA	Anëtar
5. Arta MANDRO	Anëtar
6. Ledina RIZA	Anëtar
7. Moisi DUDA	Anëtar
8. Vatë STAKA	Anëtar
9. Olger EMINAJ	Anëtar
10. Erind MERKURI	Anëtar
11. Erion FEJZULLA	Anëtar

Në mbledhjen plenare të datës 10.06.2026, në përputhje me procedurën e përcaktuar në nenet 159-161, 164 dhe vijues të Ligjit nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar dhe në nenet 18 dhe vijues, të Rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e brendshëm të Këshillit të Lartë të Prokurorisë”, shqyrtoi çështjen me objekt:

“Për caktimin e përkohshëm në pozicionin e drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier”

KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË:

Pasi mori në shqyrtim Relacionin shoqërues nr. 2281 prot., datë 03.06.2026, të Komisionit të Zhvillimit të Karrierës, dëgjoi Relatorin z. Sokol Stojani, si dhe referuar bazës ligjore të lartpërmendur, përfshirë diskutimet në mbledhje mbi çështjen,



KOPJE WEB

SEKRETA

V Ë R E N:

1. Këshilli i Lartë i Prokurorisë (në vijim, Këshilli) është institucioni që garanton pavarësinë, disiplinën, statusin dhe karrierën e prokurorëve në Republikën e Shqipërisë.
2. Me Vendimin nr. 136, datë 07.06.2023, "Për ngritjen në pozicionin e Drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier", prokurori Elion Mustafaj është caktuar nëpërmjet procedurës së ngritjes në detyrë, në pozicionin e drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier. Ushtrimi i kësaj detyre për prokurorin Elion Mustafaj ka filluar në datën 09.06.2023 dhe përfundon në datën 08.06.2026.

3. Me kërkesën administruar regjistruar me nr. 3350 prot., datë 22.12.2025, zoti Elion Mustafaj ka shprehur vullnetin për rikandidim në pozicionin e drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier, mbështetur në nenin 52, pika 2, të Ligjit nr. 96/2016, "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, ku parashikohet se:

"Jo më vonë se 6 muaj përpara mbarimit të mandatit të parë, kryetari i gjykatës ose prokurorisë me të drejtën e rizgjedhjes, mund të kandidojë për një mandat të dytë..."

4. Në zbatim të nenit 52, pika 3, të këtij ligji, të Vendimit nr. 200, datë 23.09.2020, "Për miratimin e Rregullores "Mbi kriteret dhe procedurat e ngritjes në detyrë në pozicionin e drejtuesit në prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm" dhe Vendimit nr. 171, datë 27.9.2019 "Për miratimin e Rregullores "Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore për rekrutimin, emërimin si magjistrat dhe caktimin në pozicion të kandidatëve për prokurorë, si dhe zhvillimin e karrierës së prokurorëve", i ndryshuar, me Vendimin nr. 9, datë 09.01.2026, "Për fillimin e procedurave të verifikimit të pasurisë dhe figurës për kandidatin që ka kandiduar për riemërim në pozicionin Drejtues në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier, z. Elion Mustafaj dhe caktimin me short të Relatorit për këtë procedurë verifikimi", Këshilli ka miratuar fillimin e procedurës së verifikimit të pasurisë dhe figurës për prokurorin Elion Mustafaj, procedurë e cila është ende në vijim.

5. Në nenin 52, pika 4, të ligjit të mësipërm, parashikohet se:

"Kryetari riemërohet për një mandat tjetër vetëm nëse kalon me sukses verifikimin dhe nëse vlerësimin për veprimtarinë si kryetar dhe magjistrat, është të paktën "Shumë mirë".

6. Këshilli, me Vendimin nr. 375, datë 12.12.2025, "Për miratimin e Programit që përcakton listën e prokurorëve dhe kryetarëve, për të cilët do të kryhet vlerësimi etik dhe profesional përgjatë vitit 2026, dhe caktimin me short të Relatorit dhe Këshilltarit përgjegjës për procedurat e vlerësimit", ka miratuar programin që përcakton listën e



KOPJE WEB



prokurorëve dhe kryetarëve, për të cilët do të kryhet vlerësimi etik dhe profesional përgjatë vitit 2026, si dhe ka caktuar me short Relatorin dhe Këshilltarin përgjegjës për procedurën e vlerësimit për z. Elion Mustafaj.

Aktualisht, procedura e vlerësimit sipas Rregullores “Për vlerësimin e drejtuesit të prokurorive të juridiksionit të përgjithshëm” për prokurorin Elion Mustafaj, që ka rikandiduar për një mandat të dytë në pozicionin e drejtuesit është ende në vijim.

7. Duke qenë se, procedurat administrative të mësipërme nuk kanë përfunduar ende, me qëllim vijueshmërinë e punës në zyrën e Prokurorisë Fier, si dhe duke ruajtur praktikën e deritanishme të Këshillit në raste të ngjashme, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës, në respektim të frymës së ligjit dhe në përgjigje të situatës së krijuar, ka vlerësuar caktimin përkohësisht të z. Elion Mustafaj, në pozicionin e drejtuesit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier, për një periudhë deri në tre muaj.
8. Në nenin 59, pikat 1 dhe 4, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, parashikohet se:

“1. Pozicioni i magjistratit mund të plotësohet përkohësisht, kur magjistrati me pozicion të përhershëm nuk është në gjendje të ushtrojë funksionin për një periudhë jo më shumë se tre muaj, për shkak të:

- a) *caktimit në pozicione të tjera;*
- b) *arsyeve të tjera të parashikuara nga ligji.*

.....

4. Këshilli merr vendim për rastet e parashikuara në pikën 2, të këtij neni, si dhe përcakton datën e fillimit dhe datën e mbarimit të periudhës kohore, në të cilën pozicioni mund të plotësohet përkohësisht.”

9. Neni 42 pika 2, i ligjit të sipërpërmendur, përcakton se:

“ 2... Pozicioni është përkohësisht i lirë kur magjistrati që ka atë pozicion në mënyrë të përhershme, për të paktën 3 muaj, është përkohësisht në pamundësi për të ushtruar funksionin në atë pozicion.”

10. Ndërsa, neni 3, i Vendimit nr. 64, datë 15.04.2019, “Për miratimin e Rregullores “Për caktimin e përkohshëm të prokurorëve”, i ndryshuar, përcakton se:

“1. Prokurori mund të caktohet përkohësisht në çdo pozicion të të njëjtit nivel ose të një niveli tjetër, për të cilin përmbush kërkesat dhe kriteret e parashikuara në ligj për këtë nivel apo pozicion, në të njëjtën prokurori ku ushtron funksionin ose në një prokurori tjetër.

2. Këshilli i Lartë i Prokurorisë respekton për aq sa është e mundur vullnetin e prokurorëve gjatë caktimit të përkohshëm.”



KOPJE WEB



11. Sa më sipër, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës i propozoi Këshillit, caktimin e përkohshëm të prokurorit Elion Mustafaj në detyrën e Drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier, për një afat deri në 3 muaj, duke filluar nga data 10.06.2026, pasi plotëson kushtet e përcaktuara në ligj dhe në rregullore. Ky caktim i përkohshëm mund të ndërpritet në çdo moment nëse Këshilli vendos riemërimin e tij si drejtues i kësaj zyre të prokurorisë, për një mandat tjetër 3 vjeçar.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenin 149/a, të Kushtetutës, në nenet 42, pika 2 dhe 59, pikat 1 dhe 4, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, në nenet 164 pika 8, 166 pika 2, 184, 189 pika 1, germa “a” të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” i ndryshuar, si dhe nenin 3, të Vendimit nr. 64, datë 15.04.2019, “Për miratimin e Rregullores “Për caktimin e përkohshëm të prokurorëve”, e ndryshuar, me propozim të Komisionit të Zhvillimit të Karrierës, Këshilli i Lartë i Prokurorisë,

V E N D O S I:

1. Caktimin e përkohshëm të prokurorit Elion Mustafaj në pozicionin e Drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier, për një periudhë deri në tre muaj, duke filluar nga data 10.06.2026.
2. Për periudhën e përmendur në pikën 1 të këtij vendimi, prokurori Elion Mustafaj të paguhet me pagën e pozicionit ku është caktuar përkohësisht.
3. Të njoftohen me këtë vendim prokurori Elion Mustafaj, Prokurori i Përgjithshëm dhe Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit.

U shpall në Tiranë, sot më 10.06.2026.

KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

KRYETAR

Mirela Bogdani



ZV/KRYETAR

Erind Germenji

ANËTAR
Sokol Stojani



ANËTAR
Zeqir Hoda



ANËTAR
Arta Mandro



ANËTAR
Ledina Riza




ANËTAR
Moisi Duda



ANËTAR
Vatë Staka



ANËTAR
Olger Eminaj



ANËTAR
Erind Merkuri



ANËTAR
Erion Fejzulla

